



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.195, datë 27.06.2023

PËR

“RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN VAKANT NR.1 NË  
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË, SHPALLUR ME VENDIMIN  
NR.92, DATË 09.05.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 43 dhe 44 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Miratimin e renditjes së kandidatëve për pozicionin vakant Nr.1, shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.92, datë 09.05.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë si më poshtë:
  1. Ermira Manelli
- II. Përfundimin e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidatin Ledion Tema.
- III. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
- V. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
- VII. U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj


ANËTAR  
Nurihan Sciti



**ANËTAR**  
**Eloida Goxhi**



**ANËTAR**  
**Esmeralda Keshi**



**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**



**ANËTAR**  
**Arta Mandro**



**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

